

LIGJ
Nr. 86/2024

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE UNIVERSITETIT KOMBËTAR TË
ARSIMIT NË DISTANCË (UNED) PËR HAPJEN E UNIVERSITETIT KOMBËTAR TË
ARSIMIT NË DISTANCË, KAMPUSI NË GJIROKASTËR**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Universitetit Kombëtar të Arsimit në Distançë (UNED) për hapjen e Universitetit Kombëtar të Arsimit në Distançë, kampusi në Gjirokastrë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.7.2024.

Shpallur me dekretin nr. 280, datë 31.7.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE UNIVERSITETIT KOMBËTAR TË ARSIMIT NË DISTANCË (UNED)
“PËR HAPJEN E UNIVERSITETIT KOMBËTAR TË ARSIMIT NË DISTANCË, KAMPUSI
NË GJIROKASTËR”

Kjo Marrëveshje lidhet ndërmjet:

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga znj. Ogerta Manastirliu, ministër i Arsimit dhe Sportit, në vijim referuar si “Këshilli i Ministrave”,
dhe

Universitetit Kombëtar të Arsimit në Distançë, institucion publik i arsimit të lartë, i regjistruar dhe i licencuar në Spanjë, i përfaqësuar nga rektori, dr. Ricardo Mairal Usón, në vijim i referuar njohur si “UNED”.

Në këtë Marrëveshje, Këshilli i Ministrave dhe UNED-i bashkërisht referohen njëhën si “Palët”.

Duke pasur parasysh se:

UNED-i, është universiteti publik kryesor në Spanjë për sa u përket numrit të studentëve dhe ofertave akademike, si dhe kampusi më i madh në Evropë i dedikuar ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë cilësor përmes formës së studimeve *online*, i cili dëshiron të shtrijë aktivitetet e tij akademike në Republikën e Shqipërisë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Palët në këtë Marrëveshje bien dakord për sa vijon:

Neni 1

Objektivat e përbashkët

Këshilli i Ministrave dhe UNED-i bien dakord që hapja e një kampusi të UNED-it në Gjirokastrë do të arrijë objektivat e mëposhtëm të përbashkët të Palëve:

- a) Zhvillimi i sektorit të arsimit të lartë dhe ekspertizës në studime në fusha të ndryshme, nëpërmjet metodologjisë në distancë dhe *online* në Republikën e Shqipërisë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor;
- b) Zgjerimi i ofertës arsimore spanjolle në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke mbështetur integrimin e shërbimeve të ofruara nga UNED-i dhe duke garantuar mbështetjen akademike dhe administrative të studentëve të regjistruar;
- c) Kultivimi i një mjedisi për shkëmbimin intelektual, kërkimin akademik, mirëkuptimin ndërkombëtar dhe multikulturor dhe bashkërendimin, në përputhje me traditën e jashtëzakonshme akademike të UNED-it.

Neni 2

Detyrimet e Palëve

Për qëllimet e parashikuara në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, ndarja e përgjithshme e përgjegjësiave përcaktohet, si më poshtë:

- a) Këshilli i Ministrave miraton hapjen, funksionimin dhe zhvillimin e veprimtarisë akademike të Universitetit Kombëtar të Arsimit në Distancë (UNED) në Gjirokastrë.
- b) Këshilli i Ministrave do të sigurojë njohjen automatike të gradave shkencore dhe diplomave të UNED-it në Republikën e Shqipërisë.
- c) Këshilli i Ministrave ushtron të drejtën e verifikimit ligjor të veprimtarisë së kampusit të UNED-it në Gjirokastrë.

Secila prej Palëve në këtë Marrëveshje do të bëjë përpjekjet e saj më të mira për të mbështetur Palën tjetër në mirëbesim dhe për ta mbajtur në mënyrë efektive Palën tjetër të padëmtuar nga çdo përgjegjësi që nuk është rezultat i veprimeve dhe/ose i pakujdesisë së Palës tjetër.

Neni 3

Veprimtaria akademike

Programi/programet i/e studimit që do të ofrohet/ofrohen nga kampusi i UNED-it në Gjirokastrë do të ketë/kenë të njëjtat standarde si ato të ofruara nga kampuset e tjera të UNED-it.

Rregullat dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, gjuhën e studimit, kohëzgjatjen e programit/programmeve të studimit, si dhe për mbylljen e tyre, përcaktohen në aktet rregullatore të brendshme të UNED-it.

Nga viti akademik 2024–2025 dhe në vazhdim, UNED-i hap kampusin e tij në Gjirokastrë dhe është i angazhuar të ofrojë programe studimi sipas cikleve dhe modaliteteve të duhura të studimit dhe sipas kërkesës akademike në Shqipëri.

Neni 4

Standardet e organizimit dhe kontrollit të veprimtarisë së kampusit të UNED-it

Procedurat dhe standardet e mëposhtme do të përmbushen sipas rregullave në fuqi dhe nga autoritetet përgjegjëse të vendit të origjinës (Spanjë):

- standardet e organizimit institucional;
- struktura akademike;
- standardet e personelit akademik dhe statusi i tyre;
- procedurat për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë;
- verifikimi i ligjshmërisë dhe auditimi i veprimtarisë së kampusit të UNED-it në Gjirokastrë;

Neni 5

Kriteret e pranimit dhe të regjistrimit të studentëve

Rregullat e parashikuara në aktet rregullatore të brendshme të UNED-it zbatohen për pranimin e studentëve në programin/programet e studimit që do të ofrohet/ofrohen nga kampusi i UNED-it në Gjirokastrë, si dhe për regjistrimin, caktimin e numrit të tyre të matrikullimit dhe të drejtat dhe detyrimet e studentëve.

Neni 6

Diplomimi dhe diplomat

Për procedurën e diplomimit të studentëve dhe formën e diplomave të lëshuara nga UNED-i zbatohen rregullat e parashikuara në aktet e brendshme rregullatore të UNED-it.

Njohja e gradave shkencore dhe diplomave do të bëhet sipas Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës (Spanjë).

Neni 7

Akreditimi institucional dhe i programit të studimit

Akreditimi institucional dhe programet e studimit të ofruara nga UNED-i, si dhe periudha e vlefshmërisë së tyre (të kryera nga organizatat akredituese të Spanjës) njihen automatikisht nga institucionet në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8

Logoja dhe vula e kampusit

Kampusi i UNED-it në Gjirokastrë do të ketë logon e tij zyrtare të miratuar nga UNED-i.

Vula e UNED-it ka formën dhe elementet, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi i vendit të origjinës (Spanjë) dhe prodhohet, administrohet dhe mirëmbahet në përputhje me legjislacionin në fuqi të atij vendi.

Neni 9

Emërimi i përfaqësuesve

Këshilli i Ministrave dhe UNED-i bien dakord që të gjitha aktivitetet akademike dhe rregullatore për hapjen dhe funksionimin e kampusit në Gjirokastrë do të koordinohen ngushtë ndërmjet Palëve.

Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë autorizohet nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje ta zbatojë atë në emër të Këshillit të Ministrave.

Për UNED-in, rektori i tij është i autorizuar si koordinator për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Shkëmbimi i informacionit

1. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët shkëmbejnë informacione ndërsjellë të përkatës ndërmjet tyre.

2. Secila nga Palët në këtë Marrëveshjeje do të përdorë informacionin e marrë, vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshjeje.

3. Veprimet nga Palët sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe në veçanti shkëmbimi i informacionit, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Palët do ta trajtojnë informacionin e marrë në bazë të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Dispozitat përfundimtare

Të dyja palët bien dakord të mbajnë konfidenciale të gjithë informacionin jopublik të marrë nga Pala tjetër në lidhje me këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur kërkohet nga ligji ose kur bihet dakord në mënyrë të ndërsjellë paraprakisht me shkrim.

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me përfundimin e procedurave të ratifikimit dhe do të qëndrojë në fuqi për një periudhë katërvjeçare dhe mund të zgjatet edhe për katër vjet të tjerë. Pas kësaj periudhe prej tetë vjetësh, Palët mund të lidhin një marrëveshje të re. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin reciprok të të dyja palëve, të dhënë me shkrim.

Marrëveshja mund të ndërpritet në çdo kohë, nga njëra Palë, duke informuar palën tjetër me shkrim. Pala që dëshiron ta ndërpresë këtë Marrëveshje duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër të paktën 12 (dymbëdhjetë) muaj përpara për qëllimin e saj për të ndërprerë bashkëpunimin dhe këtë Marrëveshje.

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, UNED-i dhe Këshilli i Ministrave do të përpiqen ta zgjidhin çështjen me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve të ndërsjella.

Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje nuk ndikon në detyrimet e ndërsjella të Palëve, të cilat mbijetojnë dhe duhet të përmbushen pavarësisht nga përfundimi i kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë por pa u kufizuar në detyrimet që lidhen me aktivitetet akademike, pagesat e papaguara ose kompensimet, rimbursimin e taksave etj., siç mund të jetë e zbatueshme.

Kjo Marrëveshje është nënshkruar në _____, më _____, në 2 (dy) kopje origjinale të barasvlershme, 2 (dy) për secilën gjuhë: në shqip, në spanjisht dhe në anglisht. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi në interpretim.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Ogerta Manastirliu

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Për Universitetin Kombëtar të Arsimit në Distançë (UNED):

Ricardo Mairal Usón

REKTOR

AGREEMENT
BETWEEN
COUNCIL OF MINISTERS OF THE REPUBLIC OF ALBANIA

AND
NATIONAL UNIVERSITY OF DISTANCE EDUCATION (UNIVERSIDAD NACIONAL
DE EDUCACION A DISTANCIA (UNED))

"FOR THE OPENING OF THE NATIONAL UNIVERSITY OF DISTANCE
EDUCATION, CAMPUS IN GJIROKASTRA"

This Agreement is entered into between:

The Council of Ministers of the Republic of Albania, represented by Mrs. Ogerta Manastirliu, Minister of Education and Sports, hereinafter referred to as the "Council of Ministers",
and

National University of Distance Education, public institution of higher education, registered and licensed in Spain, represented by the Rector, Dr. Ricardo Mairal Usón, hereinafter referred to as the "UNED".

In this Agreement, the Council of Ministers and UNED are referred jointly to as the "Parties".

WHEREAS:

UNED, is the leading public university in Spain in terms of the number of students and academic offers, as well as the largest campus in Europe dedicated to the internationalization of quality higher education through the form of online studies, which aspires to extend its academic activities in the Republic of Albania and the Western Balkans region.

The Parties in this Agreement agree herein on the following:

Article 1 – Common objectives

The Council of Ministers and UNED hereby agree that the opening of a UNED Campus in Gjirokastra will achieve the following joint objectives of the Parties:

- a) The development of the higher education sector and expertise in the different field studies through the distance and online methodology in the Republic of Albania and the Western Balkans region;
- b) Expanding the Spanish educational offer in Albania and the Western Balkans region, supporting the integration of services offered by UNED and guaranteeing registered/enrolled students' academic and administrative support;
- c) Cultivating an environment of intellectual exchange, academic research, international and multicultural understanding, and reconciliation, in line with the outstanding academic tradition of UNED.

Article 2 – Obligations of the Parties

For the purposes provided for in Article 1 of this Agreement, the general division of responsibilities is defined as follows:

- a) The Council of Ministers, hereby approves the opening, operation, and development of the academic activity of the National Distance Education University (UNED) in Gjirokastra.
- b) The Council of Ministers will provide for the automatic recognition of UNED degrees and diplomas in the Republic of Albania.
- c) The Council of Ministers exercises the right of legal verification of the activity of the UNED Campus in Gjirokastra.

Each of the Parties herein will make their best efforts to support the other Party in good faith and effectively keep the other Party harmless from any liability which is not a result of the actions and/or negligence of that other Party.

Article 3 – Academic activity

The study programme(s) to be offered by the UNED Campus in Gjirokastra will have the same standards as those offered by other UNED campuses.

The rules and procedures for the opening, reorganization, language of study, duration of the study programme(s), as well as for their extinction, are defined in the internal regulatory acts of UNED. From the 2024-2025 academic year onwards, UNED opens its Campus in Gjirokastra and is committed to offering study programmes within the appropriate study cycles and modalities, and according to the academic demand in Albania.

Article 4 - Standards of organization and control of the activity of the UNED Campus

The following procedures and standards will be met according to the applicable rules and by the responsible authorities of the country of origin (Spain):

- Institutional organization standards,
- academic structure,
- academic staff standards and their status,
- procedures for internal and external quality assurance,
- verification of legality and audit (legal and financial control) of the activity of the UNED Campus in Gjirokastra

Article 5 – Students' admission and registration criteria

The rules provided for in the internal regulatory acts of UNED apply to the admission of students to the study programme(s) that will be offered by the UNED Campus in Gjirokastra, as well as their registration, matriculation, and the rights and obligations of the students.

Article 6 - Graduation and diplomas

The rules provided for in the internal regulatory acts of UNED apply to the graduation procedure of students and the form of the diplomas issued by UNED.

The recognition of degrees and diplomas will be done according to the Qualifications Framework of the country of origin (Spain).

Article 7 - Institutional and study programme accreditation

The institutional accreditation and study programmes provided by the UNED, as well as their validity period (carried out by the accrediting organizations of Spain)) are automatically recognized by the institutions in the Republic of Albania.

Article 8- Logo and seal of the Campus

The UNED Campus in Gjirokastra will have its own official logo as approved by the UNED. The seal of UNED has the form and elements as defined by the applicable legislation of the country of origin (Spain) and is produced, administered, and maintained in accordance with the applicable legislation of that country.

Article 9 - Appointment of representatives

The Council of Ministers and UNED agree that all academic and regulatory activities for the opening and operation of the Campus in Gjirokastra will be closely coordinated between the Parties.

The Ministry of Education and Sports of the Republic of Albania is authorized through this Agreement to implement it on behalf of the Council of Ministers.

For UNED, its Rector is authorized as coordinator for the implementation of this Agreement.

Article 10 - Exchange of information

1. For the implementation of this Agreement, the Parties exchange mutual relevant information between them.
2. Each of the Parties to this Agreement will use the information received, only for the purposes defined in this Agreement.
3. Actions by the Parties under this Agreement, and in particular the exchange of information, must be carried out in accordance with the legislation in force for the protection of personal data.
4. The Parties will treat the information received pursuant to this Agreement in accordance with the applicable legislation.

Article 11 – Final provisions

Both Parties agree to keep confidential all non-public information received by the other Party in connection with this Agreement, except as required by law or mutually agreed in advance in writing.

This Agreement will enter into force upon the completion of the ratification procedures and will remain in force for a period of four years and may be extended for another four years. After this period of eight years, the Parties may conclude a new Agreement. This agreement may be amended only by mutual consent of both Parties, given in a written form.

The Agreement can be terminated at any time, by one of the Parties, by informing the other party in writing. The party willing to terminate this Agreement must notify the other party in writing at least 12 (twelve) months in advance of its intention to terminate the cooperation and this Agreement.


In the event of any dispute arising out of or in connection with this Agreement, the UNED and the Council of Ministers shall endeavor to resolve the matter amicably through mutual consultation. Termination of this Agreement does not affect the mutual obligations of the Parties, which survive

and have to be fulfilled regardless of the termination of this Agreement, including but not limited to obligations related to the academic activities, outstanding payments or compensations, tax reimbursement, etc., as may be applicable.

This Agreement is signed on _____, on _____, in 2 (two) original, equivalent copies, 2 (two) for each in Albanian, Spanish and English language. In case of any inconsistency, the English text shall prevail in interpretation.

For the Council of Ministers of the Republic
of Albania:

OGERTA MANASTIRLIU
MINISTER OF EDUCATION AND
SPORTS



For the National University of Distance
Education (UNED):

RICARDO MAIRAL USÓN
RECTOR

